



KONKURS PËR NDARJEN E BURSAVE STUDENTORE NGA FONDACIONI “RENOVA”

*Konkurs për ndarje të bursave për studentë të talentuar për vitin akademik
2011/2012*

KUSHTET PËR NDARJE TË BURSIVE

Të drejtën e bursës e kanë kandidatët që mësojnë në shkollat e larta dhe fakultetet e R. M-së.

II/1. Për studentët nga:

- Fakulteti Arkitekturës.
- Fakulteti i Shkencave Bioteknike.
- Fakulteti i Ndërtimtarisë.
- Fakulteti Elektroteknikës.
- Fakulteti Makinerisë .
- Fakulteti Matematiko natyror .
- Fakulteti Xehëror –Gjeologjik.
- Fakulteti Teknik në Manastir.
- Fakulteti Teknologjik –Metalurgjik.
- Fakulteti Ekonomik, Juridik, Shkencave Humane (Pedagogji – Psikologji, Filozofi-Sociologji, Histori-Gjeografi dhe Instituti i gjuhëve), Fakulteti Politeknikë dhe F. SH. M. N. (Matematik-Informatikë, Biologji, dhe Fizik-Kimi) në Universitetin Shtetëror të Tetovës.
- Fakulteti i shkencave Islame – Shkup.
- Fakulteti i shkencave Bujqësore dhe ushqimit.

Kandidatët duhet t’i plotësojnë kushtet vijuese:

- a) Studentët e vitit II, III, IV dhe të V të cilët gjatë viteve të mëparshme kanë arritur sukses me notë mesatare mbi 8 (tetë).
- b) Të mos kenë përsëritur gjatë arsimit;
- c) Të mos jenë shfrytëzues të bursave ose kredive nga institucionet apo firmat tjera;

II/2. Për studentë që studiojnë në fakultete tjera të cilët nuk janë përmendur në pikën II/1 duhet ti plotësojnë kushtet vijuese :

- a) Studentët e vitit II, III, IV, V dhe të VI të cilët gjatë viteve të mëparshme të studimeve kanë arritur së paku sukses 9 (nëntë);
- b) Të mos kenë përsëritur vitin gjatë arsimit;
- c) Të mos jenë shfrytëzues të bursave apo kredive nga institucionet ose firmat tjera;

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR PJESËMARJE NË KONKURSIN PËR BURSË PËR STUDENTË TË TALENTUAR

1. Fletëparaqitje (*merret në ambientet e Fondacionit "Renova" në momentin e aplikimit*)
2. CV (biografi)
3. Kopje të indeksit (dy faqet e para - ku është fotografia dhe faqen ku është regjistruar semestri fundit).
4. Vërtetim për semestrin e rregullt të regjistruar për vitin shkollor 2011/2012.
5. Vërtetim të notave ku mund të shihet nota mesatare.
6. Vërtetim për të ardhurat e realizuara të anëtarëve të punësuar të familjes (për anëtarët e pensionuar fletëpagesë pensioni, për ata që marrin ndihmë sociale çekun e ndihmës sociale, ata që nuk punojnë vërtetim nga enti për punësim se nuk janë në marrëdhënie pune);
7. Kopje të letërnjoftimit ose të pasaportës.

III. VLERA E BURSAVE

Vlera e bursës për nxënësit dhe studentët për vitin shkollor 2011/2012 do të jetë :

- 3.600,00 denarë në muaj bursa studentore ;

Bursat ndahen për aq vite shkollore, përkatësisht semestra, aq sa janë paraparë me planet mësimore, përkatësisht me aktet e përgjithshme të institucioneve arsimore përkatëse, bursistëve do tu ndahet bursë 9 muaj në vit (aq sa zgjatë viti akademik shkollor) ndërsa pagesa do të bëhet çdo muaj.

Kandidatëve të cilëve iu është ndarë bursa e mbajnë të drejtën e shfrytëzimit të bursës nëse gjatë shkollimit përmbajnë suksesin e nevojshëm dhe kushtet e parapara me marrëveshjen për shfrytëzimin e bursës.

IV. VENDI DHE AFATI PËR DORËZIMIN E DOKUMENTEVE

Fletëparaqitjet dhe dokumentet e nevojshme kandidatët duhet ti dorëzojnë në zyrën e **"FONDACIONIT RENOVA"** në Qendrën e Re Tregtare, lokali nr. 57 në Tetovë.

Fletëparaqitjet dorëzohen në afatet vijuese :

- për student prej vitit të II deri në vitin e V: prej **28.10.2011 deri më 05.11.2011**

Gjatë dorëzimit të dokumentacionit për bursë studentore, kandidatët duhet të kenë me vete letërnjoftimin dhe indeksin (për student).

Për rezultatet nga konkursi nxënësit dhe studentët do të lajmërohen në zyrën e Fondacionit **"RENOVA"** në Tetovë nga shtypi ditor dhe ne faqen e internetit www.renova.com.mk

SQARIM

1. Dokumentet duhet të dorëzohen personalisht nga vetë kandidati **(përndryshe janë të pavlefshme)** .
2. Dokumentet e kandidatëve që janë të pakompletuara dhe që dërgohen me vonesë, përkatësisht nuk i kanë respektuar afatet kohore të konkursit, nuk do të rrangohen.
3. Deklarata e nevojshme duhet të plotësohet nga vet kandidati.
4. Dokumentacioni i dorëzuar nuk kthehet prapë, mbetet në arkivin e Fondacionit.
5. Ç'do person i cili do të konkurroj duhet që të marrë dëshmi (numër për dosje) se i ka dorëzuar dokumentet.
6. Dokumentacioni i dorëzuar duhet të jetë i futur në kuvertë
7. Studentët të cilët kanë shfrytëzuar bursë në vitin e kaluar, për vazhdimin e bursës vlen e njëjta procedurë si për të tjerët.
8. Rezultatet do të shpallen me numra të dosjes (jo me emra).

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në tel. 044/333-227, ose në email: fondacioni_r@yahoo.com

DEKLARATË (e kandidatit)

Unë, _____

(Emri, emri i prindit, mbiemri)

Nxënës – student në _____, shkollën – fakultetin në _____.

(drejtimi)
(universiteti)

viti i studimit _____ me vendbanim të përhershëm në _____

rr. _____ nr. _____ me nr. të letërnjoftimit. _____ numri i amzës

_____ e dhënë më _____ vit, në _____ nr. tel. _____

email adresa _____

Në lidhje me kërkesën tuaj për dhënie të bursave studentore prej Fondacionit “RENOVA”, deklaroj nga ndërgjegjja morale, materiale dhe e përgjegjësisë penale se nuk shfrytëzoj bursë dhe as kredi studentore nga ndonjë dhurues tjetër.

Gjithashtu, deklaroj se në kohë të duhur do ta njoftoj Fondacionin “RENOVA” se nëse ndërkohë gjatë shkollimit tim marr ndonjë lloj burse ose kredie si dhe eventualisht nëse ndërpres shkollimin e mëtutjeshëm ose nëse bëj transfer prej një institucioni të lartë arsimor në tjetër.

Kandidati

Data _____ / _____ / _____